



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
Mbledhja nr.16
Prishtinë, më 11.5.2022, në ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, kryetar, Mërgim Lushtaku, nënkryetar, Verica Ceranik, nënkryetare, Enver Haliti, Visar Korenica, Eman Rrahmani, Avdullah Hoti dhe Pal Lekaj anëtarë.

Munguan: Jeta Statovci, Ferat Shala dhe Duda Balje.

Të ftuar: Dren Ajeti, këshilltar juridik i Kuvendit të Kosovës.

Pjesëmarrës të tjerë: Egzona Tërdevci, asistente Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Ardit Mehana, praktikant, Doresa Deliu, praktikante KDI, Violeta Smajlaj-ZKA, Lindita Rexha – GP-LVV, Egzona Kozhani- hulumtuese D+, Arbelina Selmanaj-hulumtuese D+, Ardiana Hajzeri-gazetare RTK dhe Fjolla Muçaj-hulumtuese IPS “Musine Kokalari”.

Stafi mbështetës i Komisionit: Elfete Alshiqi-Beqiri, Sabrije Saliuki, Luljeta Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Muja, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1) Miratimi i rendit të ditës;
- 2) Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura të Komisionit më 6 dhe 7 prill 2022;
- 3) Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-021 për akcizën në produktet e duhanit;
- 4) Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;
- 5) Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-033 për Provimin e Jurisprudencës;
- 6) Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Ekonomi, Ndërmarrësi dhe Tregti për Projektligjin nr.08/L-074 për Turizmin;
- 7) Formimi i tri Grupeve Punuese për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve;
- 8) Formimi i grupit punues për Shqyrtimin e Projektligjit nr.08/L-138 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore;
- 9) Të ndryshme.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura të Komisionit më 6 dhe 7 prill 2022

Mërgim Lushtaku, zëvendëskryetar, konstatoi se Komisioni me shumicë votash miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura të Komisionit më 6 dhe 7 prill 2022.

3.Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit

Mërgim Lushtaku, për këtë Projektligj është krijuar Grupi Punues dhe ftoj deputetin Z.Enver Haliti të paraqesë arsyetimin e raportit.

Enver Haliti, Grupi Punues i formuar me Vendim të Komisionit, ka mbajtur 3 takime, ku prezentë kanë qenë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Dogana e Kosovës. Grupi punues e ka shqyrtuar Projektligjin nr.08/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit dhe me këtë rast ka propozuar 13 amendamente, të cilat kanë karakter përmbajtjesor, por edhe teknik.

Armend Muja, kryetar, ftoi anëtarin e grupit punues që ti paraqesë amendamentet një nga një, dhe në rast se dikush ka kundërshtime e merr fjalën, përndryshe do të konsiderohet se janë të miratuara.

Enver Haliti, lexon amendamentet me radhë : Amendamenti 1 - Në tërë tekstin e nenit 2 fshihen thonjëzat (“ ”).

Amendamenti 2 - Neni 2, paragrafi 1.15 pas emërimit “Duhan me ngrohje” fshihet emërtimi “(filtër për cigare elektronike)“.

Amendamenti 3 - Në nenin 2, paragrafi 1.19 numrat të shënohen edhe me fjalë.

Amendamenti 4 - Neni 3, paragrafi 1.2, fshihen fjalët “ dhe cigare”.

Amendamenti 5 - Neni 3 dhe neni 4 fuzionohen në një nen dhe nenet tjera rirenditen sipas këtij ndryshimi.

Amendamenti 6 - Neni 4 paragrafi 1.8, ndryshohet si vijon: “1.8. për duhan me ngrohje, për një (1) kilogram neto”.

Amendamenti 7 - Në nenin 5 fshihen fjalët “fshihet dhe”.

Amendamenti 8 - Në nenin 6, paragrafi 1. dhe paragrafi 2. fshihen fjalët “ fshihet dhe / fshihen dhe”.

Amendamenti 9 - Në nenin 6, paragrafi 5., fjala “me qëllim” zëvendësohet me fjalën “më dashje”.

Amendamenti 10 - Në nenin 7, paragrafi 1. fshihen fjalët “fshihen dhe”.

Amendamenti 11 - Neni 7, paragrafi 8, fjala “mund” zëvendësohet me fjalën “duhet”.

Amendamenti 12 - Në nenin 8 fshihen fjalët “fshihet dhe”.

Amendament 13- Neni 11 i projektligjit riformulohet si në vijim:

Neni 20 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Subjektet dënohen me gjobë për kundërvajtje për shkeljet e përcaktuara si në vijim:

1.1. nuk llogarit ose llogarit akcizën në kundërshtim me nenin 4 dhe 5 të ligjit bazik;

1.2. vendos në treg produktet e akcizës në kundërshtim me nenin 6 të ligjit bazik;

1.3. nuk paguan akcizën brenda afatit sipas nenit 7 të ligjit bazik;

1.4. paraqet të dhëna të pasakta me qëllim të lirimit nga akciza sipas nenit 9 të ligjit bazik;

1.5 vendos në treg produktet e akcizës para se të pajiset me autorizim nga Dogana sipas nenit 11 të ligjit bazik;

1.6. transporton produkte te duhanit në kundërshtim me nenin 12 të ligjit bazik;

1.7. nuk mban evidenca për sasi të e prodhuara, qarkullimin, stoqet, mallrat në magazine sipas nenit 16 dhe 17 të ligjit bazik;

1.8 nuk raporton dhe nuk e dorëzon deklaratën e akcizës sipas nenit 16 dhe 17 të ligjit bazik;

1.9. vendos në treg produkte të duhanit në të cilat banderolat nuk janë vendosur në mënyrën e përcaktuar me ligj bazik.

2. Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni, personi juridik dënohet me gjobë si në vijim:

2.1. Për kundërvajtjet nga nënparagrafi 1.1. deri 1.6 dhe nënparagrafi 1.8 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni, dënohet me gjobë në shumë prej pesëmijë (5000) deri në pesëmbëdhjetëmijë (15,000) euro.

2.2. Për kundërvajtjet nga nënparagrafi 1.7 paragrafit 1 të këtij neni, dënohet me gjobë në shumë prej njëmijë (1000) euro deri në tremijë (3000) euro.

3. Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni, personi fizik që ushtron biznes individual dënohet me gjobë si në vijim:

3.1. Për kundërvajtjet nga nënparagrafi 1.1. deri 1.6 dhe nënparagrafi 1.8 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni, dënohet me gjobë në shumë prej tremijë (3000) deri në nëntëmijë (9000) euro.

3.2. Për kundërvajtjet nga nënparagrafi 1.7 paragrafit 1 të këtij neni, dënohet me gjobë në shumë në shumë prej njëmijë (1000) euro deri në tremijë (3000) euro.

4. Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik dënohet me gjobë si në vijim:

4.1. Për kundërvajtjet nga nënparagrafi 1.1. deri 1.6 dhe nënparagrafi 1.8 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni, dënohet me gjobë në shumë prej njëmijë (1000) euro deri në tremijë (3000) euro.

4.2. Për kundërvajtjet nga nënparagrafi 1.7 paragrafit 1 të këtij neni, dënohet me gjobë në shumë prej pesëqind (500) euro deri në njëmijë e pesëqind (1500) euro.

5. Për kundërvajtjen e përcaktuar në paragrafin 1.9 të këtij neni, përveç gjobës të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, personit juridik dhe personit fizik që ushtron biznes individual mund t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e konfiskimit të produkteve të akcizës.

Avdullah Hoti, theksoi se amendamenti 13, pika 1, nuk bën dëm nëse shkon edhe ashtu siç është sepse është një përsëritje e panevojshme, ngase me një fjali të vetme mund të thuhet se nëse shkelet neni 4 dhe 5 i ligjit bazik shqiptohet ky dënim, pa hyrë në specifikat e secilës prej këtyre gjërave.

Vërejtja ime është tek pika e 5-të, ku po thuhet personi juridik dhe personi fizik që ushtron biznes individual, a mundet një person fizik të ushtrojë biznes individual të produkteve që kanë akcizë ? E dyta, a mendoni se është e drejtë të dënohet punëtori në subjektin juridik përveç biznesit? Karshi shtetit është subjekti juridik që është përgjegjës për respektimin e ligjit, kurse një punëtor brenda atij subjekti nëse nuk i respekton rregullat, shteti merret me subjektin juridik, por nuk mund t'i shqiptosh dy gjopa të ndara.

Kryetari, ju po sugjeroni që të riformulohet amendamenti, në faqe 14 pas presjes personit juridik dhe personit fizik që ushtron biznes individual mund t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e konfiskimit të produkteve të akcizës.

Avdullah Hoti, tek pika 3 thotë për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni personi fizik që ushtron biznes individual, a është e definuar me ligjin bazik se çka ushtron person fizik që ushtron biznes individual ? Përveç në bujqësi, ku bujqit e marrin një numër fiskal edhe pse janë persona fizikë, nuk ka persona tjerë që ushtrojnë biznes individual.

Dren Ajeti, ideja pse është bërë ndarja mes personit juridik dhe personit fizik që ushtron biznes individual është për shkak të Ligjit për Shoqëri Tregtare që njeh subjektivitetin juridik të personit në momentin që zhvillon biznes dhe pajiset automatikisht me leje fiskale. Ligji e njeh vetëm si person fizik që ushtron biznes individual dhe ai mban përgjegjësi me tërë pasurinë e tij. Grupi punues e ka parë të arsyeshme edhe për shkak të tavanit që ekziston me Ligjin për Kundërvajtje që dënimi për personat fizikë që veprojnë si biznese nuk mund t'iu caktohet dënimi prej 5,000-15,000 euro, por duhet të jetë më i ulët për shkak se Ligji për Kundërvajtje e parasheh një dënim më të butë për personin fizik që ushtron biznes individual. Mungesa e kësaj kategorie do të shkaktonte që të gjitha bizneset individuale si qoshqet apo depot e ndryshme do të mbeteshin pa bazë ligjore për t'u dënuar dhe do t'i shkaktonte vështirësi inspektorëve të shqiptojnë dënime.

Eman Rrahmani, në bazë të interpretimit tuaj, po thoni se një biznes individual është një person fizik e nuk është person juridik.

Dren Ajeti, dallimi në mes personit juridik dhe personit fizik që ushtron biznes individual në praktikë do të ishte se nëse unë tani do të hap një kioskë dhe filloj të ushtrojë veprimtarinë, unë do të regjistrohesha si biznes individual dhe mbaj përgjegjësi me tërë pasurinë time. Ligji për Shoqëritë Tregtare thotë se personi fizik që ushtron biznes individual nuk është person juridik dhe se ndaj tij aplikohet dispozitat e personave juridik. Gjithashtu, edhe Ligji për Kundërvajtjet e bën këtë diferencim.

Avdullah Hoti, tha se e kuptoj se janë definuar në këtë mënyrë me ligj, por me biznese kemi të bëjmë gjithmonë me persona juridikë, varet se a është biznes individual apo ka status tjetër. Kjo mund të tejkalohet nëse bëjmë një amendament tek përkufizimet e termeve tek ligji bazik, ku themi se personi fizik i referohet biznesit individual në këtë projektligj.

Dren Ajeti, kjo është diskutuar edhe me përfaqësuesit e Doganës së Kosovës, sepse edhe ata kanë thënë se i qasemi në mënyrë të njëjtë si personit fizik që ushtron biznes individual ashtu edhe personit juridik. Mirëpo, problemi është tek gjordat për shkak se Ligji për Kundërvajtje tavanin maksimal për personin fizik që ushtron biznes individual e parasheh 10,000 euro nëse dyfishohet,

ndërkaq për personat juridikë e parashih deri në 40,000 euro. Kjo është edhe arsyeja e ndarjes, ngase personin fizik që ushtron biznes individual nuk kemi mundur të parashohim dënim më shumë se 10,000 euro, kurse për personin juridik kemi paraparë deri në 15,000 euro.

Kryetari, pajtohem me Z.Hoti dhe sugjeroj që tek përkufizimet e ligjit të bëhet ky dallim me anë të një amendamenti se çka konsiston personi fizik që ushtron biznes individual.

Avdullah Hoti, pyet se a janë bërë konsultimet me Odën Ekonomike dhe shoqatat përkatëse ?

Enver Haliti, përgjigjet se ka pasur takime me Odën Ekonomike dhe nuk është se kanë propozuar ndonjë amendament që kemi parë ne si Grup Punues të arsyeshme të përfshijmë në këtë raport. Kanë kërkuar që të respektohen Direktivat Evropiane dhe kanë dërguar si të tilla në gjuhën angleze.

Avdullah Hoti, pyet se a kanë pasur ndonjë vërejtje për amendamentet ?

Enver Haliti, tha se nuk kanë pasur asnjë vërejtje.

Pal Lekaj, meqenëse kam qenë anëtar i këtij Grupi Punues dhe jemi konsultuar edhe me Doganën e Kosovës, Zyrat Ligjore dhe Odat Ekonomike dhe ne nuk kanë pasur vërejtje. Dallimi mes personit fizik dhe juridik është se person fizik mund të jetë ndonjë zyrtar që i shkakton dëm kompanisë dhe e merr përgjegjësinë si person fizik, ndërsa si person juridik merret pronari i kompanisë, dhe nuk mund të i shmangemi ligjit bazik.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari, konstatoi se Komisioni me shumicë votash miratoi katërmëdhjetë (14) Amendamentet e propozuara në kuadër të Projektligjit nr.08/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit.

Pas votimit të amendamenteve, Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr.08/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit.

2. Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.08/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-021 për Akcizën në Produktet e Duhanit, procedohet në komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Kryetari, Projektligji nr.08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, është shqyrtuar nga Komisioni

Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, i cili komision ka dërguar raportin me amendamente. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e Komisionit të përhershëm, deklarohet për koston shtesë të Projektligjit dhe amendamenteve, dhe raportin me rekomandime e procedon tek Komisioni Funksional. Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, në bazë të Deklaratës së Ndikimit Buxhetor dhe Financiar, vlerëson se zbatimi i Projektligjit nuk krijon kosto shtesë buxhetore.

Pasi nuk pati diskutime për këtë pikë, Kryetari hodhi në votim raportin me Amendamentet e propozuara, dhe konstatoi se: Komisioni me shumicë votash, ka vendosur që Komisionit funksional t'ia paraqesë këtë :

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-033 për provimin e Jurisprudencës

Kryetari, Projektligji nr.08/L-033 për provimin e Jurisprudencës, është shqyrtuar nga Komisioni Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, i cili komision ka dërguar raportin me amendamente. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e Komisionit të përhershëm, deklarohet për koston shtesë të Projektligjit dhe amendamenteve, dhe raportin me rekomandime e procedon tek Komisioni Funksional. Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, në bazë të Deklaratës së Ndikimit Buxhetor dhe Financiar, vlerëson se zbatimi i Projektligjit nuk krijon kosto shtesë buxhetore.

Pasi nuk pati diskutime për këtë pikë, Kryetari hodhi në votim raportin me Amendamentet e propozuara, dhe konstatoi se: Komisioni me shumicë votash, vendosi që Komisionit funksional t'ia paraqesë këtë :

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-033 për provimin e Jurisprudencës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-033 për provimin e Jurisprudencës nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional për Ekonomi, Ndërmarrësi dhe Tregti për Projektligjin nr.08/L-074 për Turizmin

Kryetari, Projektligji nr.08/L-074 për Turizmin, është shqyrtuar nga Komisioni Funksional për Ekonomi, Ndërmarrësi dhe Tregti, i cili komision ka dërguar raportin me amendamente. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e komisionit të përhershëm, deklarohet për koston shtesë të Projektligjit dhe amendamenteve, dhe raportin me rekomandime e procedon tek Komisioni Funksional. Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, në bazë të Deklaratës së Ndikimit Buxhetor dhe Financiar, vlerëson se zbatimi i Projektligjit nuk krijon kosto shtesë buxhetore.

Pasi nuk pati diskutime për këtë pikë, Kryetari hodhi në votim raportin me Amendamentet e propozuara, dhe konstatoi se: Komisioni me shumicë votash, vendosi që Komisionit funksional t'ia paraqesë këtë :

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-074 për Turizmin, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional Ekonomi, Ndërmarrësi dhe Tregti për nr.08/L-074 për Turizmin nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Formimi i tri Grupeve Punuese për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve

7.1 Në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni me shumicë votash, vendosi që të formojë, Grupin Punues për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës me këtë përbërje:

- 1.Avdullah Hoti, kryesues,
- 2.Armend Muja, anëtar,
- 3.Eman Rrahmani, anëtar,
4. Jeta Statovci, anëtare,
- 5.Mërgim Lushtaku, anëtar.

7.2 Në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni me shumicë votash, vendosi që të formojë, Grupin Punues për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 me këtë përbërje:

- 1.Pal Lekaj, kryesues,
- 2.Eman Rrahmani, anëtar,
- 3.Visar Korenica, anëtar,
- 4.Duda Balje, anëtare,
- 5.Verica Ceraniq, anëtare.

7.3 Në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni me shumicë votash, vendosi që të formojë, Grupin Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet më këtë përbërje:

1. Mërgim Lushtaku, kryesues,
2. Jeta Statovci, anëtare,
3. Visar Korenica, anëtar.

8. Formimi i grupit punues për Shqyrtimin e Projektligjit nr.08/L-138 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore me këtë përbërje

Bazuar në Rregulloren e Kuvendit, Komisioni me shumicë votash formoi Grupin Punues për Shqyrtimin e Projektligjit nr.08/L-138 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore me këtë përbërje :

- 1.Enver Haliti, kryesues,
- 2.Visar Korenica, anëtar,
- 3.Mërgim Lushtaku, anëtar.

9. Të ndryshme

Mbledhja përfundoi në orën 11:00

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Armend Muja,

Kryetar i Komisionit